



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.655/ 5 prot

Datë 24 .03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 415 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24 .03.2026 me:

**Objekt:** Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-76992-02-23-2025, me objekt: Blerje Kompjuter, pritera, me fond limit 1,645,500 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G. Adresa: Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/1, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Maliq  
Adresa: Bulevardi Rinia, Maliq.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndyshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-76992-02-23-2025, me objekt: Blerje Kompjuter, pritera, me fond limit 1,645,500 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6375, datë 02.03.2026 dhe me nr. 655/2026 prot., datë 02.03.2026 i operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.3. Me shkresën nr. 655/1 prot., datë 10.03.2026, me objekt Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën, drejtuar AK-së, Komisionit të Prokurimit Publik kërkoi informacion të hollësishëm mbi trajtimin e ankesës dhe vendimmarrjen e autoritetit kontraktor mbi ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK për procedurën e mësipërme objekt ankimi.

II.4. Me shkresën nr. 1529/1 prot., datë 13.03.2026, protokolluar me tonën me Nr. 655/2 prot., datë 17.03.2026, Autoriteti Kontraktor ka përcjellë me shërbim postar dokumentacionin e tenderit dhe si edhe procedurën e shqyrtimit të ankesës.

Me Vendimin me Nr. 13 datë 12.03.2026, KSHA ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës në lidhje me pikën e parë të pretendimeve të ankesës.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon

*1 Në specifikimet teknike per Desktop 2 , nder te tjera eshte kerkuar qe paisja te kete DVD+/-RW te inkorporuar. DVD-RW eshte nje teknologji e vjeter, e cila nuk gjendet ne asnje nga kompjuterat e prodhuar ne 2025 e ne vijim. Per kete qellim AKSHI e ka hequr nga specifikimet teknike, dhe ka lene opsionin qe per kompjuterat e rinj kjo te oftohet si njeri external, pra te furnizohet se bashku me PC por jo i incorporuar (pasi kjo do te kufizonte ofertat vetem ne kompjutera me te vjeter) por : DVD+/-RW (mund të përdoret dhe DVD+/-RW e jashtme, jo domosdoshmërisht e të njëjtës markë me kompjuterin) Per sa me siper kerkojme modifikimin e kesaj kerkese, duke e pranuar edhe ofertat me Desktop me DVD+/-RW te jashtme.*

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranur pretendimin e ngritur në pikën e parë të ankesës me argument:

Duke ju referuar kërkesës së operatorit ekonomik mbi ndryshime të specifikimeve teknike, argumentojmë se kjo kërkesë në thelb nuk ndryshon funksionalitetin e materialeve të kërkuara dhe sugjerojmë që të merret parasysh pretendimi dhe të bëhen ndryshime në DST si vijon:

“Media Device”	DVD+/-Rw
----------------	----------

Të bëhet

“Media Device”	DVD+/-Rw (i jashtëm)
----------------	----------------------

III.1.2. Referuar Nenit 30 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

Neni 115 pika 1 dhe 3 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.3. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-76992-02-23-2025, me objekt: Blerje Kompjuter, pritera, me fond limit 1,645,500 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Autoriteti kontraktor të marrë masa për modifikime të specifikimeve teknike objekt pranimi nga KSHA.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III. 2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

**2** Ne shtojcen 8 pika 2.2.1 kerkon Bilancet 2022,2023,2024 ndersa ne piken Kerkesa e mesiperme nuk eshte ne perputhje me LPP dhe aktet nenligjore ne mbeshtetje te tij.Procedura objekt ankimimi eshte procedure E hapur e Thjeshtuar. Per keto procedura, LPP dhe VKM per RPP parashikon se Kriteret ekonomike financiare duhet te jene te thjeshtuara, dhe keto te fundit provohen me paraqitjen e vertetimit te xhiros per 3 vitet e fundit. ( neni 55 pika 4 I VKM 285 date 19.05.2021)

Per sa me siper kerkojme heqjen e kesaj kerkese.

III.2.1 Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST Shtojcën 8, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet, 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

**2.2.2** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore

III.2.2. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.3. Në nenin 77, pikat 1/2/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “I Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

**b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

III.2.4. Referuar Nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 1 dhe pika 4, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimale tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e

*përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Referuar Nenit 55 “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” pika 4 i VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikon se: “[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.[...]”

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve ligjvënës i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në rastin konkret, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë sipas **2.2.1** *Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet 2022,2023,2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009, neni 41, pika”c”, ....në përmbushje të kapaciteteve financiare. Gjithashtu AK ka kërkuar që operatorët të paraqitin Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2023,2024,2025, sipas kriterit **2.2.2**.*

Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë të Kritereve për Kualifikim, mbi kapacitetet financiare të operatorëve ekonomikë, gjykon se Autoriteti Kontraktor me kërkesa të tilla ndikon në uljen e konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke kufizuar pjesmarrjen e përfaqësuesve të bizneseve në këtë procedurë prokurimi, duke mos u dhënë mundësi operatorëve të tjerë ekonomikë të cilët mund të zotërojnë kapacitet e duhura për pjesmarrje në procedurën objekt ankimi.

Paraqitja nga ana e ofertuesve njëkohësisht e bilanceve vjetore per tre vite (kriteri 2.2.1) dhe xhirove vjetore (kriteri 2.2.2.), për procedurat e hapura të thjeshtuara, kur legjislacioni parashikon që Autoritet Kontraktore të formulojnë kërkesa minimale në proporcion me llojin e procedurave, fondin limit dhe sasinë e mallrave për prokurim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se këto kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe se kriteri 2.2.1, nuk është në proporcion me natyrën, objektin e kontratës sasinë dhe fondin limit, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikime të kritereve kualifikuese sa më sipër cituar, për të zgjeruar pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

Përsa argumentuar Komisioni gjykon se përmbushja e kritereve kualifikuese, përse i përket kapaciteteve ekonomiko financiare, autoriteti kontraktor me kriteret e kërkuara ka rënduar pozitativisht e operatorëve ekonomikë në tërësi dhe të përfaqësuesve të biznesit të mesëm dhe të vogël.

Sa më sipër, në analizë të llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “procedurë e hapur e thjeshtuar” si edhe të elementeve të tjera të procedurës së prokurimit, ku legjislacioni parashikon që autoritet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin 2.2.1. mbi dorëzim të kopjeve të bilanceve të certifikuara, dhe se plotësimi i kapaciteteve ekonomiko financiare të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhirove vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

**III.3.** Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

*Me kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4 AK ka vendos si kriter kualifikimi 2.3.3 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit sipas shtojces 8 ,një punësim mesatar i të paktën 2 (dy) punonjësve për muajin e fundit b. Punonjës shofer 2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 2 punonjës të kualifikuar si më poshtë: 1. 2. Nje Punëtor të Thjeshte Te dyja keto kerkesa nuk jane ne perputhje me parashikimet e LPP dhe VKM per RPP per procedurat E hapur, e thjeshtuar. **Se pari**, kerkesa per 2 punonjes nuk eshte proporcionale me madhesine e kontrates. **Se dyti**, lloji i punonjesve te kerkuar (shofer dhe puntor) nuk kane lidhje me objektin e kontrates (blerje Kompjutera). Transporti dhe ngarkim shkarkimi jane nje element qe nuk zene as 0.5% te Kosatos totale te kontrates dhe nuk mund te vendosen si kriter kualifikimi. AK duhet te vendosi kriteret kualifikimi qe kane lidhje me objektin, si psh OE te kete te punesuar nje IT per te ndjekur mbarevajtjen e kontrates, me shume se sa shofer dhe punonjes ngarkim shkarkimi.*

*Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e ketyre 2 pikave, duke ndryshuar kerkesen per 2 punonjes (shofer dhe puntor i thjeshte) me kerkesen per 1 punonjes te diplomuar ne nje nga degjet e Informatikes.*

III.3.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST Shtojcën 8, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, **2.3 Kapaciteti teknik.**

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet te deklaroje në formularin e vetdeklarimit sipas shtojces 8 një punësim mesatar i të paktën 2 (dy) punonjësve për muajin e fundit.

*“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

**Dhe**

b. **Listpagesat** e konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore te punonjesve sipas formatit qe kerkohet ngalejtlacioni ne fuqi per muajin e fundit.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 2 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **1 (nje) punonjës shofer**

*“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

*Kur mjetet jane ne pronesi*

- 1. kontrata e punës (e vlefshme)*
- 2. Leje Drejtimi kategoria B*

*Kur mjetet jane me qera*

*Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me shoferin deri ne perfundimin e afateve te kontrates.*

- **(1) nje punetor te thjeshte**

*Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

- 1. kontrata e punës e vlefshme;*

*Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar ne natyren e procedures se prokurimit ku kerkohet blerja e mallrave dhe dorezimi i tyre prane autoritetit kontraktor, eshte kerkuar se operatori ekonomik duhet te kete nje mjet per transportin e mallrave dhe per drejtimin e mjetit operatori ekonomik te duhet te vertetoje se disponon nje shofer. Per kryerjen e kesaj procedure eshte kerkuar edhe nje punonjes i thjeshte per te bere te mundur levizjen e mallrave objekt prokurimi.*

III.3.2. Në nenin 77, pikat 2 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1 Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.3.3. Referuar Nenit 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 1 dhe pika 5, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet:

*1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.*

*5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në

përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Komisioni vëren, se synimi bazë i autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i mallrave objekt-prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe realizimin me sukses të kontratës.

Referuar testit të proporcionalitetit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se këto kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe se kriteri i vendosur nuk është në proporcion me natyrën, objektin e kontratës, sasinë e mallrave objekt prokurimi, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin të DST me qëllim për të zgjeruar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

Përsa konstatuar dhe analizuar Komisioni gjykon se pretendimet mbi uljen e numrit të punonjësve janë të drejta dhe Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikim të kriterit 2.3.3. për uljen e numrit të punonjësve të kërkuar.

Pretendimet për kriterin 2.3.3. mbi numrin e punonjësve qëndrojnë.

III. 3.5. Në lidhje me pretendimet për **Kriterin 2.3.4, lloji i punonjësve të kërkuar (shofer dhe puntor) nuk kanë lidhje me objektin e kontratës (blerje Kompjuterë). Transporti dhe ngarkim shkarkimi janë një element që nuk zëne as 0.5% të Kostos totale të kontratës dhe nuk mund të vendosen si kriter kualifikimi.** AK duhet të vendosi kriterë kualifikimi që kanë lidhje me objektin, si psh OE të këtyre të punësuar në IT për të ndjekur mbarevajtjen e kontratës, me shume se sa shofer dhe punonjës ngarkim shkarkimi.

*Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e ketyre 2 pikave, duke ndryshuar kerkesen per 2 punonjës (shofer dhe puntor i thjeshte) me kerkesen per 1 punonjës te diplomuar ne nje punonjës ne nje nga degët e Informatikes.*

Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimit dhe në analizë të tyre gjykon se Autoriteti kontraktor ka përgjegjësi në hartimin e kriterëve për kualifikim gjithmonë në proporcion me elementët e procedurës së prokurimit., por mbi të gjitha në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rastin konkret kriteri objekt ankimi është një kriter i cilin nuk ka lidhje me llojin e procedurës së prokurimit, objekti i së cilës është Blerje pajisje Kompjuterë dhe Printera, duke bërë që ky kriter të jetë objekt ankimi nga operatorët e interesuar për procedurën.

Referuar ankesës Komisioni i gjykon të drejta pretendimet e operatorit ekonomik mbi punonjësit dhe kualifikimet e tyre, duke rezultuar kriter konfuz dhe jo proporcional me natyrën e kontratës, gjithashtu duke rezultuar kriter i dubluar.

Komisioni, referuar dokumentit *Model procesverbali mallra i saktësuar kompjutera*, gjykon se Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar qartë hartimin e kriterit mbi kualifikimet e personelit të nevojshëm të punonjësve të kërkuar për realizimin e procedurës, duke rezultuar kriter joproporcional me elementët e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të hartojnë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi të hapur të thjeshtuar dhe vetëm kriteret në përputhje me objektin e prokurimit.

Përsa analizuar më sipër Komisioni gjykon, se kriteri objekt ankimi është një kriter i pa argumentuar dhe me kërkesa që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit.

Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë shtojcën 8 duke hequr kriterin kualifikues **2.3.4**.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues mbi modifikim të kriterit 2.3.4 mbi kualifikimet e punonjësve qëndron pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

***4 Ne piken 2.3.2** eshte vendosur si kriter kualifikimi: Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka 1(nje ) mjet transportuese, kamioncine (furgon) me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 1ton deri ne 1,5 ton, dhe me pas te paraqesi dokumentacioni perkates. Kerkesa per mjet transporti me kapacitet 1-1.5 ton nuk eshte ne perputhje me LPP dhe VKM per RPP.*

*Se pari ky kriter kualifikimi nuk lidhet me objektin e kontrates, dhe si I tille nuk mund te vendoset si kriter kualifikimi. Se dyti, vertet transporti eshte nje element I Kosos ( transporti I produkteve deri ne destinacion) por perben me pak se 0.5% . Si i tille nuk mund te jete kriter skualifikimi per nje OE qe oferton produktet e kerkuara me cmimin me te ulet Se treti, perse duhet nje kapacitet mbajtes prej 1.5 ton kur ne total produktet objekt prokurimi peshojne jo me shume se 300kg? Se katerti, per procedurat E hapur e Thjeshtuar, ne nenin 55 te VKM per RPP percaktohet se: 4.Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm*

*Ne kete kuptim, AK duhet te mjaftohet me kerkesen kualifikuese qe ka parashikuar ne piken 2.3.7 Operatori ekonomik duhet te deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjentëve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara Kjo deklarate eshte mese e mjaftueshme per te kualifikuar OE.*

III.4.1 Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST Shtojcën 8, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, **2.3 Kapaciteti teknik**

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka 1(nje )mjet transportuese, kamioncine (furgon) me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 1ton deri ne 1,5 ton ,

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

a) Për mjetet në pronësi:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme
5. Certifikate për leje transporti të leshuar nga Bashkia

dhe permjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata ( e vlefshme)
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme.]
6. Certifikate për leje transporti të leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve të marra me qera nga operatorët ekonomike bazuar në njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit të mallrave ) ,mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak por për përdorim nga të tretet.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Keto mjete janë të nevojshme për të bërë transportin e mallit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Eshtë kërkuar një mjet kamioncine (furgon) me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 1 ton deri ne 1,5 ton duke marrë parasysh dhe natyrën e mallrave që do të transportohen sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në destinacion

**2.3.7.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara.

III.4.2. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë

*organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.4.3. Në nenin 40, pika 5 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar parashikohet se: “**5.** *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.*

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përmbushjen dhe realizimin e kontratës sipas kërkesave të vendosura. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në e ndryshuar dhe rregullat e prokurimit publik, të ndryshuar, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së, i ndryshuar.

III.4.5. Bazuar në sa më sipër dhe referuar testit të proporcionalitetit, llojit të procedurës së prokurimit, vlerës së kontratës, natyrës dhe sasisë së mallit si edhe mënyrës së shpërndarjes në autoritet, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme që operatorët ekonomikë të marrin përsipër të lëvrojnë mallrat objekt prokurimi në autoritet me mënyra alternative transporti, me mjetet e tyre apo edhe me kompani transporti të specializuara për këtë qëllim.

Komisioni gjykon që operatori ekonomik ka detyrimin të kryejë transportin e mallit me mjete të sigurta përsa i përket dorëzimit të mallrave të pa dëmtuara dhe në kohën dhe vendin e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Gjithashtu Komisioni sjell në vëmendje rolin e autoritetit kontraktor në fazën e ekzekutimit të kontratës, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet kontraktuale të palëve në zbatimin dhe realizimin me sukses të procedurës së prokurimit në kohën e duhur dhe me cilësinë e kërkuar.

Përsa më sipër autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin objekt ankimi sipas konstatimeve të mësipërme të KPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

**III.5.** Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

*5 Ne pikën 2.3.9 kerkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **vetëdeklarim garancie** 1-vjeçare për artikujt e kërkuar (gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë zëvendësimin ose riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike) dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci per mallrat si më poshtë vijon:*

Jemi dakort ne lidhje me periudhen e garancise 1 vjecare, periudhe e cila perfshin zevendesimin dhe/ose riparimin e produkteve sipas kushteve te garancise, por nuk jemi dakort qe OE te ofroje dhe sherbimin dhe mirembajtjen si pjese e garancise. Paisjet objekt prokurimi kane nevojte per mirembajtje te vazhdueshme ( update software, kontrolle periodike, pastrim ne rastin e printerave etj ) keto nuk mund te jene te perfshira ne garancine e produktit. Per sa me siper kerkojme ndryshimin e kesaj pike ne:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie 1-vjeçare për artikujt e kërkuar (gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë zëvendësimin ose riparimin pa pagesë ne perputhje me fleten e garancise ) dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci per mallrat si më poshtë vijon:*

III.5.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST Shtojcën 8, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, **2.3 Kapaciteti teknik**

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie 1-vjeçare për artikujt e kërkuar (gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë zëvendësimin ose riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike) dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci per mallrat si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi	Sasia	Njesia matëse
1	Laptop	1	Copë
2	Kompjuter (Desktop)	15	Set
3	Printer Personal	7	Copë

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë

*se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi, mirëmbajtja dhe shërbimi pa pagesë*

III.5.2. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj ka përgjegjësi të përcaktojë kriteret e veçanta për kualifikim në lidhje me cilësinë dhe funksionin e tyre, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim/specifikimet teknike duhet të pasqyrojnë saktë dhe qartë nevojat e autoritetit kontraktor për mallra apo shërbime, në mënyrë të tillë që të orientojnë operatorët ekonomikë të hartojnë ofertat e tyre, të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.5.3. Referuar pretendimeve të ankesës, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimit dhe vëren, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka përcaktuar objektin e prokurimit: “Blerje Kompjuter dhe printera” dhe kërkesa që pajisjet të shoqërohen me fletë garanci është e drejtë e Autoritetit, Kriter i cili është vendosur nga AK për të siguruar mallra me cilësi dhe që do të funksionojnë sipas kërkesave të AK-së, dhe në raste difektesh nga prodhimi, AK përfiton shërbimin e riparimeve apo zëvendësimeve të natyrave të ndryshme sipas kushteve të përcaktuara, ku shitësi përgjigjet për difektet e pajisjeve brenda periudhës së garancisë.

Komisioni vëren se AK gjithashtu ka kërkuar në kriterin objekt ankimi, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike, që referuar objektit të prokurimit, autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar si zë më vete mirëmbajtje të pajisjeve, çka do të thotë së nënkërkesa e kriterit “shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike“, del jashtë objektit të prokurimit duke rezultuar si një kërkesë jo në proporcion edhe me fondin limit, e paargumentuar gjithashtu në procesverbalin përkatës, duke rezultuar kërkesë konfuze dhe rëndon pozitën e operatorëve ekonomikë.

Në përfundim të analizës së fakteve Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përcakton nevojat që i duhen, ndaj duhet të hartojë kriteret dhe në procedurën objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë të mirëargumentuara, të përcaktuara qartë dhe saktë në shtojcat përkatëse, me qëllim që të orientojnë drejtë operatorët ekonomikë në përlllogaritjet e kostove të mallrave apo shërbimeve dhe përgatitjen e ofertave të tyre. Gjithashtu hartimi i saktë i dokumenteve të tenderit, ndihmon autoritetin kontraktor me synim që të realizojë procedurën në kohë dhe me sukses dhe pa u bërë objekt ankesash nga operatorët ekonomikë.

Komisioni gjykon se Autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë qartë dhe parashikuar shërbimin e mirëmbajtjes të pajisjeve në kriterin 2.3.9. dhe kërkesa objekt ankimi rezulton një kërkesë e paqartë që nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, konfuze për operatorët ekonomikë

dhe Autoriteti kontraktor të marrë masa për modifikim të kriterit 2.3.9, duke hequr përcaktimin shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike).

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-76992-02-23-2025, me objekt: Blerje Kompjuter, pritera, me fond limit 1,645,500 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë shtojcën në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

